



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
DURRES

Numri i Çështjes 71041-01780-11-2018 Data e Regjistrimit 7/19/2018
Numri i Vendimit 11-2019-600 Data e Vendimit 5/16/2019

VENDIM
NE EMER TE REPUBLIKËS

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR DURRES E PERBERE NGA:

KRYESUES: Joana Qeleshi

ANËTAR

SEKRETARE Rozana Kongjoni

Objekti: Me vendim gjykate per lidhje te procedimit penal nr.143/2018 ne ngarkim te shtetases Olesia Duka. Kerkoj qe te hiqet masa e sekuestrimit e vendosur per pronen qe une disponoj.

Baza Ligjore : Neni 274 i K.Pr.Penale.

Përmbledhja e vendimit:

Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, Gjykata, pasi shqyrtoi kërkesën e kërkuarit ***** dhe pasi dëgjoi palët që në diskutimet përfundimtare kërkuar:

Përfaqësuesja e kërkuarit *** Av.Shqiponja Meta, kërkoj:**

- Heqjen e sekuestrimit preventiv të apartamentit në emër të kërkuarit ***** , vendosur me vendimin nr.48/1, datë 15.02.2018 të ***** së Rrethit Gjyqësor Durrës.

kërkoj:

- Pranimin e kërkesës së kërkuarit ***** , pasi prona është fituar me anë të kontratës ligjore dhe mendojmë se kjo pasuri nuk duhet të mbahet e sekuestruar.

Vëren:

Në datën 19.07.2018 kërkuari ***** ka depozituar pranë ***** së Rrethit Gjyqësor Durrës kërkesën për heqjen e sekuestrimit preventiv vënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës me vendimin nr.48/1, datë 15.02.2018 mbi pasurinë apartament ndodhur në Durrës, lagjja nr.13, Plazh, me nr.pasurie 39/146+1-15, vol.73, faqe 64, ZK 8518, me sipërfaqe 63,2 m2 të kërkuarit ***** .

Kërkesa i ka kaluar për shqyrtim Gjyqtarës Eda Kaja, si gjyqtare e hetimeve paraprake të këtij procedimi penal, e cila me vendimin e veçantë nr.92, datë 13.12.2018 ka vendosur: *"Kalimin e çështjes penale me objekt heqjen e*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
DURRES

sekuestros preventive vënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës me vendimin nr.48/1, datë 15.02.2018, për gjykim pranë gjyqtarit kompetent të shqyrtimit të çështjes paraprake. Kundër vendimit lejohet ankim së bashku me vendimin përfundimtar.”, duke iu kaluar çështja për shqyrtim gjyqtarit Petraq Çuri si gjyqtar i seancës paraprake.

Me vendimin e veçantë nr.3, datë 14.01.2019 të ***** së Rrethit Gjyqësor, Gjyqtari Petraq Çuri ka vendosur: “ 1.Kalimin e kërkesës penale të datës 19.07.2018, me objekt: Heqjen e sekuestros preventive, vënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr.48/1 datë 15.02.2018 mbi pasurinë apartament ndodhur në Durrës, L. 13, Plazh, me nr.pasurie 39/146+1-15, ZK 8518, me sip.63,2 m2 të kërkuarit *****”, për gjykim gjykatës e cila do të gjykojë çështjen e themelit të çështjes penale me të pandehur Olesia Duka, e akuzuar për kryerjen e veprës penale të “Mashtrimit” parashikuar nga neni 134/2, 3 të Kodit Penal. 2.Dërgimin e akteve gjykatës kompetente të themelit. Kundër vendimit lejohet ankim së bashku me vendimin përfundimtar”.

Duke qenë se çështja penale në ngarkim të të pandehurës Olesia Duka me nr.regj.(53200-00201) 255, datë 17.01.2019, me shortin elektronik të kësaj date më është caktuar mua, Gjyqtare Joana Qelesi, kërkesa e shtetasit ***** për heqjen e sekuestros preventive po shqyrtohet nga unë, si Gjyqtarja e caktuar për gjykimin e çështjes së themelit.

Kërkesa e shtetasit ***** u shqyrtua bashkërisht me çështjen e themelit në ngarkim të të pandehurës Olesia Duka, në prani të kërkuarit ***** dhe përfaqësueses së tij, Av.Shqiponja Meta e zgjedhur me deklaram nga kërkuari, si dhe në prani të mbrojtësve të të pandehurës Olesia Duka, Av.Sokol Mengjesi dhe Av.Klodjan Skenderaj.

Nga shqyrtimi gjyqësor i çështjes rezultoi se:

***** pranë ***** së Shkallës së Parë Durrës, në datën 26.01.2018 ka regjistruar procedimin penal nr.143/2018, për veprën penale “Mashtrimi”, të parashikuar nga neni 143/3 i Kodit Penal në ngarkim të të pandehurës Olesia Duka.

Në funksion të këtij hetimi, në datën 15.02.2018 ***** ***** së Shkallës së Parë Durrës ka paraqitur pranë ***** së Rrethit Gjyqësor Durrës kërkesën për caktimin e masës së sigurimit “sekuestro preventive” për pasuritë e paluajtshme:

1. Lloji i pasurisë apartament, ndodhur në Tiranë, zona kadastrale nr.8380, nr.pasurisë 2/216+1-5, volumi 1, faqe 32, Shk.1, Kt.3, Ap.5;
2. Lloji i pasurisë apartament, ndodhur në Tiranë, zona kadastrale



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
DURRES

nr.8310, nr.pasurisë 8/117+2-21, volumi 4, faqe 54, Shk.2, Kt.4, Ap.21, nr.reference 803;

3. Lloji i pasurisë apartament, ndodhur në lagjja nr.13, Plazh, Durrës, zona kadastrale nr.8318, nr.pasurisë 39/146+1-15, volumi 73, faqe 64, Shk.1, Ap.15;
4. Lloji i pasurisë apartament, ndodhur në Tiranë, zona kadastrale nr.8310, nr.pasurisë 5/72+2-13, volumi 4, faqe 152, referenca nr.5292.

Me vendimin nr.48/1, datë 15.02.2019 të ***** së Rrethit Gjyqësor Durrës është vendosur: *“Pranimi i kërkesës së Prokurorisë pranë ***** së Shkallës së Parë Durrës. Vendosjen e sekuestros preventive, parashikuar nga neni 274 i Kodit të Procedurës Penale për apartamentet:*

- *Lloji i pasurisë apartament, ndodhur në Tiranë, zona kadastrale nr.8380, nr.pasurisë 2/216+1-5, volumi 1, faqe 32, Shk.1, Kt.3, Ap.5;*
- *Lloji i pasurisë apartament, ndodhur në Tiranë, zona kadastrale nr.8310, nr.pasurisë 8/117+2-21, volumi 4, faqe 54, Shk.2, Kt.4, Ap.21, nr.reference 803;*
- *Lloji i pasurisë apartament, ndodhur në lagjja nr.13, Plazh, Durrës, zona kadastrale nr.8318, nr.pasurisë 39/146+1-15, volumi 73, faqe 64, Shk.1, Ap.15;*
- *Lloji i pasurisë apartament, ndodhur në Tiranë, zona kadastrale nr.8310, nr.pasurisë 5/72+2-13, volumi 4, faqe 152, referenca nr.5292...”*

Ndaj vendimit të mësipërm është ushtruar ankim nga ana e të pandehurës Olesia Duka dhe me vendimin nr.10-2018-676 (57), datë 28.03.2018, Gjykata e Apelit Durrës ka vendosur: *“Lënien në fuqi të vendimit nr.48/1, datë 15.02.2018 të ***** së Rrethit Gjyqësor Durrës, me këtë ndryshim: Heqjen e sekuestros preventive mbi pasuritë:*

- *Apartament, ndodhur në Tiranë, me sipërfaqe 65 m2, me nr.2/216+1-5, volumi 1, faqe 32, zona kadastrale nr.8380;*
- *Apartament, ndodhur në Tiranë, me sipërfaqe 64,5 m2, me nr.8/117+2-21, volumi 4, faqe 54, zona kadastrale nr.8310...”*

Në datën 19.07.2018, shtetasi ***** i është drejtuar ***** së Rrethit Gjyqësor Durrës me kërkesë për heqjen e sekuestros preventive mbi pasurinë apartament, ndodhur në lagjja nr.13, Plazh, Durrës, zona kadastrale nr.8318, nr.pasurisë 39/146+1-15, volumi 73, faqe 64, Shk.1, Ap.15, me arsyetimin se kjo pasuri është e tij, pasi është fituar nëpërmjet kontratës së shitblerjes nr.13373 rep., nr.8414 kol., datë 18.11.2016, me palë shitëse



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
DURRES

Olesia Duka dhe palë blerëse *****

Gjatë seancës gjyqësore, përfaqësuesi i Prokurorisë pranë ***** së Shkallës së Parë Durrës deklaroi se e gjen të bazuar kërkesën e shtetasit *****; pasi prona është fituar me anë të kontratës ligjore dhe kjo pasuri nuk duhet të mbahet e sekuestruar.

Pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga kërkuesi ***; si dhe provat e administruara në fashikullin hetimor, Gjykata çmon se kërkesa për heqjen e sekuestros është e bazuar në ligj dhe në prova, e si e tillë duhet pranuar.**

Gjykata vëren se vendimi i gjyqtarit të hetimeve paraprake për vendosjen e sekuestros mbi pasurinë apartament nr.39/146+1-15, volumi 73, faqe 64, Shk.1, Ap.15, ndodhur në lagjen nr.13, Plazh, Durrës, zona kadastrale nr.8318, është bazuar mbi të dhënat e marra në atë moment nga ana e organit të akuzës, duke u dyshuar se pasuria në fjalë ishte pronë që i përkiste të pandehurës Olesia Duka, duke qenë se nga aktet e marra nga Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Durrës rezultonte se kjo pasuri ishte e regjistruar në emër të të pandehurës.

Ndërkohë nga aktet e depozituara nga Z. *****; rezulton se pasuria në fjalë i është tjetërsuar Z. ***** me kontratën nr.13373 rep., nr.8414 kol., datë 18.11.2016, në të cilën është ndjekur e gjithë procedura e parashikuar nga ligji për shitjen e pasurisë dhe e pandehura Olesia Duka i ka shitur Z. ***** apartamentin në fjalë, kundrejt vlerës 2.000.000 lekë, shumë e cila rezulton të jetë e likuiduar nëpërmjet mandatit bankar bashkëlidhur praktikës.

Megjithëse Z. ***** nuk ka regjistruar pranë Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Durrës kontratën e shitblerjes, referuar parashikimeve të Kodit Civil, si dhe Vendimit Unifikues nr.1, datë 06.01.2009 të Kolegjeve të Bashkuara të ***** së Lartë, titulli i pronësisë nuk lidhet me regjistrimin dhe për sa kohë ekziston një kontratë shitblerje ky përbën dhe titullin e pronësisë me të cilin prona rezulton në pronësi të Z. ***** pavarësisht mos regjistrimit të saj. Fakti i regjistrimit lidhet me dijeninë për të tretët dhe nuk sjell pasoja ligjore për efekt të parashikimeve të Kodit Civil. Konkretisht në këtë vendim Kolegjet e Bashkuara të ***** së Lartë janë shprehur se: *“...Pronësia mbi një pasuri të paluajtshme kalon në çastin e lidhjes së kontratës së tjetërsimit të kësaj pasurie. Blerësi ose përfituesi i kësaj pasurie bëhet pronar i ligjshëm i saj që në momentin e nënshkrimit të kontratës duke fituar dhe të gjitha të drejtat dhe detyrimet që lidhen me qënien e tij si pronar mbi këtë pasuri... Regjistrimi ose transkriptimi i një veprimi juridik nuk është një element i vlefshmërisë së tij (kontratës). Mosregjistrimi i kontratës në regjistrat e pasurive të paluajtshme nuk e bën kontratën e tjetërsimit të pasurive të paluajtshme të pavlefshme, por nuk i jep mundësinë blerësit që ta tjetërsojë atë tek të tretët. Kontrata e cila nuk*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
DURRES

është e regjistruar është e perfeksionuar dhe e vlefshme dhe ka efektet thelbësore. Me nënshkrimin e kontratës së tjetërsimit të pasurisë së paluajtshme, përfituesi i të drejtave bëhet pronar i pasurisë së paluajtshme dhe ky legjitimohet të ushtrojë të drejtat e tij përkundrejt të tretëve, përveç tjetërsimit të pasurisë së paluajtshme në favor të të tretëve...”.

Për rrjedhojë, duke qenë se në rastin konkret provohet që pronar i pasurisë është Z. ***** dhe jo e pandehura Olesia Duka, Gjykata çmon se jemi përpara kushteve të nenit 274/3 të Kodit të Procedurës Penale, i cili parashikon se: *“1. Kur ka rrezik që disponimi i lirë i një sendi që lidhet me veprën penale mund të rëndojë ose të zgjasë pasojat e saj ose të lehtësojë kryerjen e veprave penale të tjera, me kërkesën e prokurorit, gjykata kompetente urdhëron sekuestrimin e tij me vendim të arsyetuar. 2. Sekuestroja mund të vendoset edhe për sendet, produktet e veprës penale dhe çdo lloj pasurie tjetër që lejohet të konfiskohet, sipas nenit 36 të Kodit Penal. 3. Kur ndryshojnë kushtet e zbatimit, gjykata, me kërkesën e prokurorit ose të të interesuarit, e heq sekuestron.”* dhe sekuestro e vendosur nga gjyqtari i hetimit paraprak duhet të hiqet duke qenë se prona është në pronësi të kërkuarit *****

Shpenzimet gjyqësore në masën 500 lekë (nga të cilat: 200 lekë taksa gjyqësore dhe 300 lekë njoftime) të parapaguara nga kërkuari mbeten në ngarkim të tij.

Për keto arsye:

Baza Ligjore:

Bazuar në nenin 274 të Kodit të Procedurës Penale, Gjykata



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
DURRES

Vendosi:

1. Pranimin e kërkesës së kërkuarit *****.
2. Heqjen e sekuestros preventive të vendosur mbi pasurinë apartament me sipërfaqe 63.20 m², me numër pasurie 39/146+1-15, vol.73, faqe 64, zona kadastrale 8518, ndodhur në Durrës, lagjja nr.13, Plazh, të vendosur me vendimin nr.48/1, datë 15.02.2018 të ***** së Rrethit Gjyqësor Durrës.
3. Shpenzimet gjyqësore në shumën 500 (pesëqind) lekë mbeten në ngarkim të kërkuarit.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankimi brenda 5 ditëve në Gjykatën e Apelit Durrës, duke filluar ky afat nga e nesërmja e shpalljes së tij.

U shpall sot, në Durrës, më datë 05.02.2019.

Ky dokument është marrë nga www.gjykata.gov.al. Ai ka vlerë të plotë informuese, por nuk shërben si dokument zyrtar. Ky i fundit lëshohet nga autoritetet përkatëse.